



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.13/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 26.07.2024 të parashtruar nga ankuesi A. Sh. [redacted] nga Gjilani, për inicimin e procedurës disiplinore, më datë 29.07.2024, mori këtë:

AKTIVENDIM

HEDHET ankesa e parashtruar nga ankuesi A. Sh. [redacted] nga Gjilani, e datës 26.07.2024, për inicimin e procedurës disiplinore konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Arsyetim

Më datë 26.07.2024, parashtruesi i ankesës A. Sh. [redacted] ka paraqitur ankesë urgjente, duke kërkuar nga autoriteti kompetent që të iniciojë procedurë disiplinore dhe të verifikojë nëse ndonjë gjyqtar është i përfshirë në rastin e matjeve gjeodezike për ngastrën kadastrale 1905-5.


Në ankesë, i njëjti thekson se më datë 26.07.2024 janë bërë matje gjeodezike në ngastrën kadastrale 1905-5 e cila është në procedurë gjyqësore në lëndën e evidentuar me shenjën C.nr.1923/21, mirëpo nuk ka informata të sakta se kush i ka bërë matjet dhe a është e përfshirë Gjykata Themelore në Gjilan, apo ndonjë gjyqtar ose gjyqtare. Përmes këtyre matjeve gjeodezike mund të tentohet të dëmtohen të drejtat e tij pronësore dhe ka kërkuar nga gjykata informata zyrtare nëse ndonjë gjyqtar ka dal tek ngastrat kadastrale 1905-6 dhe 1905-8 më datë 26.07.2024 me kërkesë të S. [redacted] Xh. [redacted] dhe Xh. [redacted]. Ka theksuar se lënda është e kurdisur nga gjyqtari V. [redacted] S. [redacted], ndërsa ka kërkuar të fillohen hetimet për të verifikuar nëse ndonjë gjyqtar është i përfshirë në këtë rast, si dhe nëse gjyqtarja Mirvete Alidema është eventualisht e përfshirë.

Pas shqyrtimit të ankesës, bazuar në nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, autoriteti kompetent konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e papabuar dhe nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore.

Pretendimet e ankuesit nuk konsistojnë në shkeljet disiplinore të parapara me këtë ligj, për ndonjë gjyqtar. Për më tepër, nga kjo ankesë nuk mund të vërtetohet se ndaj kujt kërkohet të iniciohet procedura disiplinore, cila është shkelja e pretenduar disiplinore dhe cilat janë ato veprime të ndërmarra që nuk janë të parapara me dispozitat ligjore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e parashtruesit A. Sh. [redacted] nga Gjilani, e datës 25.03.2024, është e palejuar dhe për të njejtën ka vendosur sipërshtetësisht në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetar i Gjykatës,
Vehar Salihu



Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit të ankesës,
2. KGJK-së
3. Dosjës së lëndës.